



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1014/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “American Hospital Kosova” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810812158 dhe seli në Prishtinë, “Rruga e Shkupit” nr. 25, kundër debitorit “Italian Group” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810020529 dhe seli në Prishtinë, Magjistratja Prishtinë – Ferizaj, km. 5, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ekrem Hoxha, avokat nga Prishtina, duke vendosur sipas kërkesës së debitorit për kthim në gjendje të mëparshme e datës 11.11.2021, për shkak të humbjes së afatit për paraqitje të prapësimit si dhe prapësimit të paraqitur ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 97/21, i lejuar me datë 12.02.2021, nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, jashtë seancës me datë 20.09.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e paraqitur nga debitori “Italian Group” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810020529 për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 97/21, i lejuar me datë 12.02.2021, nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, si e PASAFATSHME.
- II. HEDHET POSHTË prapësimi i debitorit “Italian Group” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810020529, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 97/21, i lejuar me datë 12.02.2021, nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, si i PASAFATSHËM.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme, Faturës nr. 2020/092039, e datës 02.11.2020, dhe Faturës nr. 2020/091999, e datës 02.11.2020, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 97/21, të datës 12.02.2021, me të cilin është urdhëruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit

shumën prej EUR 8,908.68, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e arritjes për pagesë të faturave, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, me datë 11.11.2021, ka paraqitur propozim për kthim në gjendjen e mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 97/21, të datës 12.02.2021, me arsyetim se debitorit asnjëherë më parë nuk i janë dorëzuar shkresat personalisht dhe as ndonjë punëtori të tij, duke theksuar se të gjitha komunikimet janë bërë me shkelje ligjore. Ka shtuar se debitorit nuk i është dhënë mundësia e pranimit të rregullt të urdhrin përmbarimor, për faktin se adresa e mëhershme me të cilën supozohet se është bërë dorëzimi, nuk është njoftuar në mënyrë të rregullt ngase nuk ka pranuar asnjë dokument nga përmbaruesi. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që të aprovohet kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme, dhe të anulohet vendimi P.nr. 97/21, apo të vendoset sipas prapësimit të debitorit.

Së bashku me kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme, debitori ka paraqitur edhe prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor, me arsyetim se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri nuk janë të pranuar apo nënshkruara nga debitori dhe si rrjedhojë të njëjtat nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë. Më tej, ka theksuar se faturat të cilat është dashur të lëshohen konform kushteve të cilat palët i kanë përcaktuar me kontratë, është dashur të pranohet në formë të rregull, të nënshkruhet dhe ndaj tyre të mos ketë kundërshtime, ndërsa ka shtuar se faturat mbi të cilat është lejuar urdhri nuk janë pranuar nga debitori për shkak të mbi faturimit dhe mos përputhjes me kushtet e kontratës mes palëve. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj në tërësi si të bazuar, ashtu që urdhri përmbarimor të shfuqizohet.

Gjykata gjen se përmbaruesi privat, në pamundësi për t'ia dorëzuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 97/21, të datës 12.02.2021, debitorit në adresën e tij në Prishtinë, magjistratja Prishtinë-Ferizaj, km. 5, përmes konkluzionit P.nr. 97/21, të datës 23.06.2021, komunikimin me debitorin e ka realizuar përmes afishimit të shkresave në tabelën e shpalljeve, ndërsa pas kalimit të afatit prej shtatë (7) ditëve, meqenëse nuk ka pranuar mjet goditës nga ana e debitorit, ka vazhduar me veprimet përmbarimore në drejtim të ekzekutimit të kërkesës që del nga dokumentet e besueshme.

Sipas nenit 18 të LPP-së, përcaktohet se *“Dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, të parapara për dërgimin e shkresave, vlejnë edhe për aktvendimin për përmbarimin, urdhrin për*

përmbarrim, aktvendimin lidhur me prapësimin kundër aktvendimit për përmbarrim dhe aktvendimit për gjobën me të holla”.

Ndërsa, me nenin 114 të Ligjit për procedurën kontestimore përcaktohet se: *“Në qoftë se dorëzimi i shkresës subjektit të regjistruar në regjistrin publik nuk mund t’i bëhet në adresën e treguar në regjistër, komunikimi bëhet duke u ngjitur shkresa në tabelën e shpalljeve të gjykatës, dorëzimi konsiderohet i kryer pas skadimit të afatit prej shtatë ditësh nga dita e afishimit në tabelën e shpalljeve të gjykatës”*

Në këtë drejtim, Gjykata gjeti se Përmbarruesi Privat, ka zhvilluar komunikimin e shkresave me debitorin konform dispozitës së nenit 114 të Ligjit për procedurën kontestimore, duke i afishuar shkresat në tabelën e shpalljes së Përmbarruesit Privat, në pamundësi të komunikimit me debitorin në adresën e regjistruar në regjistrin publik.

Me nenin 130, paragrafi 2 të LPK-së, përcaktohet se *“Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkakun e mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin”,* ndërsa me paragrafin 3 të të njëjtit nen përcaktohet se *“Pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme”.*

Prandaj, marrë parasysh faktin se dorëzimi i urdhrit përmbarrimor P.nr. 97/21, i datës 12.02.2021 është konsideruar i rregullt pas kalimit të afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e afishimit të të njëjtit në tabelë të shpalljes, konkretisht me datë 01.07.2021, ndërsa kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme debitorit e ka paraqitur me datë 11.11.2021, rezulton se e njëjta është paraqitur pas kalimit të afatit gjashtëdhjetë (60) ditor, brenda të cilit ka mundur të ushtrohet propozimi.

Në këtë drejtim, gjykata gjen se kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme është paraqitur pas kalimit të afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, përkatësisht me datë 11.11.2021, dhe si rezultat i kësaj, duke u mbështetur në nenin 17 të LPP-së, në lidhje me nenin 133 të LPK-së i cili përcakton se *“Propozimin e paraqitur pas afatit, apo propozimin e palejueshëm për kthimin në gjendjen e mëparshme gjykata e hedhë poshtë me anë të aktvendimit”,* gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe prapësimin e paraqitur nga ana e debitorit dhe gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm.

Sipas vlerësimit të Gjykatës dorëzimi i urdhrit përmbartimor P.nr. 97/21, i datës 12.02.2021 është konsideruar i rregullt me datë 01.07.2021, ndërsa debitori ka ushtruar prapësimin kundër urdhrit për përmbartim me datë 11.11.2021, dhe rrjedhimisht jashtë afatit ligjor të paraparë me dispozitën e nenit 70 të LPP-së, i cili përcakton se *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrit përmbartues”*.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 70 të LPP-së, nenit 133, paragrafi 1 të LPK-së, si dhe nenit 13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1014/22, datë 20.09.2023

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.